



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
SHKENCA SHOQËRORE**



Prishtinë, qershor 2008

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t' u përgjigjeni 100 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t' i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t' u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t' ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e sakta.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë, shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t' u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

Lexo me kujdes fragmentin e mëposhtëm, të përbërë prej dy paragrafëve, dhe përgjigju pyetjeve prej 1 deri në 18.

I.

Dola jashtë qytetit, përtej Urës së Bahçallekut. Fillova me recitue: *“Përmbi lumë të Babilonit, atje ndejem dhe lotueme, kah na shkonte malli i Sionit”*. Ecëshem i vetmuem. U mendojshem me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë. Por nata mue më kishte xanë, nata e mendjes. Un nuk dijshej ma se kah me ia mbajtë. Ku jam? Ku shkoj? Aty? Atje? Ku? Ç’do të baj?

E ndjeva vedin se nuk ishem kurrëgjja tjetër por një tullumbac në hava që sillet në atë drejtim që ta çojë era. E shka asht era? A thue asht vetë jeta? Trishtim i madh!
O zot, rri me ne se asht kah erret!

II.

E kupton? Ti ke ardhë këtu në kohën ma t’keqe që ka pas Katolicizmi ndonjiherë e sidomos na. Ktheu në katund, aty ku ishe, struku, mos fol, as mos i beso as këmishës sate. Na kemi nevojë për ty që të jetojsh e jo me deké. Na pleqtë edhe në ardhhtë puna me deké, e kemi kositë livadhin, por ju të rijs duhet të jetoni. Zoti asht i Madh. I kjosim fal atij të lumit që ka krijue vdekjen, se për ndryshej njerzit do t’kishin me kenë skllav të tiranve. Edhe kta do t’desin një ditë, e ti duhesh t’jetojsh vetëm sa me tregue. Kurrëgjja në mos kjos i zoti me ba rrno vetëm për me tregue. A e kupton shka po du me t’thanë? Mbaruen të tjerët, mbarojmë na, mbaron edhe ti: të gjithë shkojnë si qeni në rrush po nuk kje dikush me kallxue si kje puna. Kush te teproj le të kallxojë! Nuk asht fjala që po mbarojmë sot. E dijmë këtë. Nuk duhet të mbarojmë për nesër e për shekujt e ardhshëm. E kupton këtë? Fra Zef un jam sot për sot Superjor: po ta jap urdhër: Ik rrno! Vetëm për me tregue!

At Zef Pllumi
(Rrno vetëm për me tregue)

1. Paragrafi i parë i tekstit është:

- A. ese;
- B. reportazh;
- C. prozë poetike;
- D. fragment drame.

2. Togfjalëshi: „shkojnë si qeni në rrush”, në paragrafin e dytë, e ka kuptimin:

- A. vdesin kot;
- B. shkojnë shpejt;
- C. mbeten pa ngrënë;
- D. bëjnë dëm.

3. Në paragrafin e dytë, **informacioni themelor** nga del motoja „*rrno vetëm për me tregue*” është:

- A. Nuk duhet të mbarojmë për nesër e për shekujt e ardhshëm;
- B. Të gjithë shkojnë si qeni në rrush po nuk kje dikush me kallxue si kje puna;
- C. Na pleqtë edhe në ardhje puna me dekë, e kemi kositë livadhin, por ju të riht duhet të jetoni;
- D. Na kemi nevojë për ty që të jetosh e jo me dekë.

4. Në paragrafin e parë, fjalia: „*O Zot rri me ne se asht kah erret!*” **shpreh:**

- A. frikën nga perëndimi i diellit dhe nga errësira;
- B. besimin në Zot dhe frikën nga nata e errët;
- C. mosbesimin në të ardhmen dhe frikën nga Zoti;
- D. besimin në Zot dhe frikën nga e ardhmja e pasigurt .

5. Fjala te paragrafi i parë: „*Por nata mue më kishte xanë, nata e mendjes*”, **ka kuptimin:**

- A. më kishte zënë nata, ndaj nuk shihja mirë;
- B. rrugica ishte e pandriçuar;
- C. nuk arrija të mendoja kthjellët dhe arsyeshëm;
- D. ishte natë e vonë dhe më merrte gjumi.

6. Fjala: ***kjoshim*** e ka kuptimin:

- A. qofshim;
- B. qafshim;
- C. kishim;
- D. ishim.

7. Në paragrafin e dytë, fjalia: „*Mbaruen të tjerët, mbarojmë na, mbaron edhe ti*” **mbështetet mbi:**

- A. një analizë socio-kulturore;
- B. një gjendje politiko-sociale;
- C. fakte kulturo –historiko;
- D. analizën gazetareske të gjendjes.

8. Në paragrafin e dytë, fjalia: „*...të gjithë shkojnë si qeni në rrush po nuk kje dikush me kallxue si kje puna*” **në shqipen standarde** bën:

- A. Të gjithë ikin sikur qeni në rrush, mos qoftë dikush për të kallxuar si ishte puna;
- B. Të tërë shkojnë sikurse qeni në rrush nëse dikush nuk tregon se si paska qenë puna;
- C. Të gjithë shkojnë sikur qeni në rrush, po të mos ishte dikush për me treguar se si ishte puna;
- D. Të gjithë shkojnë si qeni në rrush, po nuk qe dikush për të treguar se si qe puna.

9. **Titulli më i përshtatshëm** për pjesën e parë do të ishte:

- A. Fillova me recitue;
- B. Mbi lumë të Babilonit;
- C. Nata e mendjes;
- D. Kah me ia mbajtë.

10. Gjuha e përdorur në të dy paragrafët është:

- A. toskërishte;
- B. gegërishte;
- C. arbërishte;
- D. çamërishte.

11. Cili diskurs mbizotëron në paragrafin e dytë?

- A. nacional;
- B. politik;
- C. kulturor;
- D. religjioz.

12. Fjala: „*u mendojshem*” në fjalinë „*U mendojshem me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë*”, **në shqipen standarde** bën:

- A. u mundohshim;
- B. u mundonim;
- C. mundohesha;
- D. mundoheshim.

13. Tema qendrore e këtij teksti ka të bëjë me:

- A. luftën;
- B. ideologjinë;
- C. letërsinë;
- D. artin.

14. Personazhi të cilit i drejtohet teksti i paragrafit të dytë është:

- A. i rrezikuar nga pushteti;
- B. i përkëdhelur i pushtetit;
- C. inferior ndaj pushtetit;
- D. prift që shikon punët e veta.

15. Në fund të fjalisë: „*Mos i beso as këmishës sate*”, **duhet të vihet:**

- A. pikëpresja;
- B. pikëpyetja;
- C. pikë çuditësja;
- D. dy pikat.

16. Folja tregoj në mënyrën habitore të kohës së kryer, veta e parë njëjës, forma veprare bën:

- A. paça treguar;
- B. pata treguar;
- C. paskështa treguar;
- D. paskam treguar.

17. Periudha: „*U mendojshem me e shpejtue hapin, që të mos më xajë nata në rrugë*” në paragrafin e dytë është:

- A. e bashkërenditur,
- B. e nënrenditur;
- C. pyetëse;
- D. dëshirore.

18. Fjala *skllav* në shumës bën:

- A. skllavër;
- B. skllava;
- C. skllavë;
- D. skllavër.

Lexo poezinë e mëposhtme dhe përgjigju pyetjeve nga 19 deri më 23.

KUSH JE TI?

Kush je ti? Sfidë e shekujve,
grusht i tiranëve, tmerr i mbretërve.
Lirinë kërkon. Pushka s'ka çark.
Fluturimin do e krahët s'i hap.
Me raso je veshur, zotin tall.
Kush je ti? Perëndi a djall?

Herë Bethoven, herë Kajam.
Nuk e di kur qesh, nuk e di kur qan.
Ofeli e ëmbël, korb që të tremb,
të dhemb kaq shumë e s'di ç'të dhemb.
Hamlet i ngrysur, Sanço hokatar,
gjysmë asket, gjysmë mëkatar.

Herë urrejtje, herë dashuri.
Kush je ti? Zjarr apo hi?
Zhurmën e pëlqen, heshtjes i flet,
gjysma lolo, gjysma mbret.
Këmbët në Boston, zemrën në Ballkan.
Njëri sy të qesh, tjetri sy të qan.

Duart të ngrijnë, zjarrin s'e ndez.
Lumenjtë i pi e etja të djeg.
Heshtje e shurdhër, gjëmim hata.
Kush je ti, kush je ti, pra?
Oh, po pas dilemës u fshehka gjeniu,
brenda një loti ndritka njeriu.

Kështu ngjitesh e zbret shekujve;
sfidë e harrimit, tmerr i mbretërve,
zjarr që përvëlon, kallkan acar.
Kush je ti? NOLI shqiptar!

(Bardhyl Londo)

19. Forma e kësaj poezie është:

- A. sonet;
- B. varg i matur;
- C. akrostik;
- D. varg i lirë.

20. Vargjet: „*Duart të ngrijnë, zjarrin s’e ndez
Lumenjtë i pi, e etja të djeg*”,
shprehin **figurën** e

- A. antitezës;
- B. epentezës;
- C. anaforës;
- D. epiforës.

21. Forma e **shkrimit të figurshëm** si në fjalinë: „*zjarr që përvëlon, kallkan acar*”,
është tipike për:

- A. fjalime politike;
- B. tekste gazetareske;
- C. tekste letrare;
- D. dokumente zyrtare.

22. Vargu: „*Fluturimin do, krahët s’i hap*” **interpretohet** si:

- A. pamundësi për të fluturuar;
- B. mungesë vendosmërie;
- C. dashuri ndaj fluturimit;
- D. mungesë e krahëve.

23. Në këtë tekst poetik autori e identifikon poetin Fan Noli me Hamletin e Shekspirit.

Këtë e bën për **faktin** se Noli:

- A. kishte fat të njëjtë me atë të Hamletit;
- B. dëshironte të identifikohet me Hamletin;
- C. poeti e kishte pasur mik personal Hamletin;
- D. ishte përkthyes i tragjedisë Hamleti.

Lexo me kujdes fragmentin e mëposhtëm, të përbërë nga tre paragrafë, pastaj përgjigju pyetjeve nga 24 deri në 30.

I.

Fëmijët i porosit ta duan vendin dhe gjuhën tonë gjer në vuajtje. Të mos u shqasë zemra kundër Shqipërisë as kur do të vuajnë pa faj. Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret. Këtu kanë lindur, këtu të rrojnë me mish e shpirt, qoftë edhe me dhembje.

II.

Profesionizmi në letërsi, në vendin tonë, është, hë për hë, një rrugë vuajtjesh, buka e tij është e hidhur. E hidhur, them, për atë që s'di marifete dhe hipokrizira. Terreni i letërsisë është një tokë ku gëlojnë gjarpërinjtë. Të vrasin shokët, se u bën hije. Dhe kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti për letërsi.

III.

Dorëshkrimet ua lë atyre të dyve, sidomos Pandeliut. Të mos i prek askush! Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e porealizuara, do t'i përpunojë. Për këtë duhet të grumbullojë më parë shumë kulturë. Talenti, prirja nuk vlejnë asgjë pa punë, pa kulturë.

Askush të mos i prek dorëshkrimet para se të më rritet djali! I vini në arkë, i mbyllni!"

Mitrush Kuteli
(Testamenti, 1965)

- 24.** Fjala: *marifet* në fjalinë: “*E hidhur, them, për atë që s’di marifete*” e ka kuptimin e:
- A. dredhisë dhe djallëzisë;
 - B. lojës dhe humorit;
 - C. misterit dhe prapavijës;
 - D. smirës dhe hipokrizisë.

- 25.** Sipas autorit: „*Profesionizmi në letërsi, në vendin tonë është hë për hë, një rrugë vuajtjesh*” pasi që:
- A. Atdheu është atdhe, bile edhe atëherë kur të vret;
 - B. Talenti, prirja nuk vlejnë asgjë pa punë, pa kulturë;
 - C. Terreni i letërsisë është një tokë ku gëlojnë gjarpërinjtë;
 - D. Për këtë duhet të grumbullojë më parë shumë kulturë.

- 26.** Cila fjali në paragrafin e dytë paraqet **informatë themelore**?
- A. Kur nuk u bën hije do të thotë se nuk je i zoti;
 - B. Profesionizmi në letërsi është një rrugë vuajtjesh;
 - C. Terreni i letërsisë është një tokë ku gëlojnë gjarpërinjtë;
 - D. E hidhur, them, për atë që s’di marifete dhe hipokrizira.

27. Në paragrafin e tretë fjala „**Ay**”, në fjalinë „*Ay do të rritet, do të lexojë shënimet e perealizuar, do t’i përpunojë*”, ka kuptimin:

- A. ty;
- B. ai;
- C. aty;
- D. ti.

28. Fjalët: „*prirja, letërsi, vuajtjesh*”, në gramatikë janë:

- A. folje;
- B. ndajfolje;
- C. mbiemra ;
- D. emra.

29. Shenja e pikësimit ’ e vendosur ndërmjet *s* dhe *d*, në konstruktin *s’di* është

- A. presje;
- B. thonjz;
- C. apostrof;
- D. pikëpresje.

30. Testamenti është **rrëfim intim** për:

- A. familjarët dhe porosi për fëmijët;
- B. shokët dhe porosi për miqtë e tij;
- C. lexuesit dhe porosi për masat e gjëra;
- D. prindërit dhe porosi për të parët e tij.

ENGLISH LANGUAGE

31. Read the following sentence:

The disastrous earthquake happened on _____ 32.

The correct alternative of the spoken form of this sentence is _____ :

- A. the seven of September seventeen hundred
- B. the seventh of September, seventeen
- C. the seventh of September, seventeen and
- D. September the seventh, a thousand seven hundred

32. You are going to travel long distance and are considering the most convenient means of transport. Look at the table below and choose the correct answer:

| Means of transport | Advantages | Disadvantages |
|--------------------|--|---|
| Car | Takes you wherever you want to go, cheap, | Traffic jams, not safe, cannot read, sleep, cannot watch the world go by |
| Train | No traffic jams, fast, comfortable, can read, watch the world go by | Expensive, crowded, cannot take you door to door, need a taxi or bus to the railway station |
| Bus | Cheap, can read, sleep, watch the world go by | Not very comfortable, blocked roads, speed limit, cannot walk or stand |
| Ship | Comfortable, luxurious, cheap, can socialize, relax, make the most of it | Takes too long, makes you seasick, dangerous if you can't swim |
| Airplane | Fast, comfortable, can read, sleep, eat | Very expensive, dangerous, need a taxi or bus to airport |

- A. You can relax while travelling by car and enjoy the world around you.
- B. Travelling by ship is convenient because it doesn't take too much time.
- C. Air transport is much cheaper than railway transport.
- D. Travelling by bus is not as comfortable as travelling by train.

33. Read the following sentences carefully:

1. On the way we saw Sandy and Sally and picked them up.
2. There was so much fish in the river that they went crazy after the bait.
3. We had nothing planned so we decided to go fishing in the river.
4. It was a nice sunny summer July morning.
5. We went home happy to be able to bring along a bag full of fresh fish.

The correct order of sentences to form a paragraph is _____.

- A. 4 3 1 2 5
- B. 3 2 5 4 1
- C. 2 1 4 5 3
- D. 1 3 5 2 4

34. Choose a word to complete the following sentence:

I finished my course and I was among the winning participants. We were all _____ special prizes.

- A. won
- B. earned
- C. awarded
- D. deserved

35. Read the following sentences and then choose a sentence to complete the dialogue:

Sandy: I am taking my driving test tomorrow. I'm so scared.

Simon: _____

- A. Good fortune.
- B. Have a good time.
- C. Good luck.
- D. Have a safe drive.

36. In the following dialogue:

Robert: Someone's broken into my house last night.

Tania : Did you report _____ to the police?

from the following expressions:

- 1. the burglary
- 2. the mugging
- 3. the bribery
- 4. the arson

Tania should say, '**the burglary**' because _____.

- A. someone has put Robert's house on fire.
- B. someone has stolen things from Robert's house.
- C. someone has attacked Robert in front of his house.
- D. someone's got into his house and offered him money for a favour.

37. Choose the correct answer to complete the question:

Of all the fruit I like _____ best because it's so juicy.

- A. a orange
- B. an orange
- C. orange
- D. the orange

38. Look at the following nouns. One of these words DOES NOT exist. Which one?

- A. manhood
- B. girlhood
- C. boyhood
- D. sonhood

39. Choose the correct sentence:

- A. If I didn't work hard in the company, I wouldn't travel abroad so much.
- B. If didn't I work hard in the company, I wouldn't travel abroad so much.
- C. Didn't I work hard in the company if I wouldn't travel abroad so much.
- D. I didn't work hard in the company if I wouldn't travel abroad so much.

40. Look at the words in the box:

ninety-six – who – my – old – he – interesting - had - life – years – an – is

The correct combination to form a sentence is:

- A. My grandfather is ninety-six years old, who had an interesting life.
- B. My grandfather, who is ninety-six years old, had an interesting life.
- C. My old grandfather is ninety-six years, who had an interesting life.
- D. My grandfather who ninety-six years old is, had an interesting life.

41. Which word is different?

- A. bright
- B. tight
- C. fight
- D. right

42. In the words given below the underlined letter(s) is pronounced in the same way EXCEPT in one. Which one?

- A. hear
- B. smart
- C. remark
- D. least

43. In the string of word bookcase, plant, shelf, desk, table, the word plant is different because _____.

- A. it isn't an object
- B. it's a piece of furniture
- C. it's in the house
- D. it isn't in the house

44. Read the paragraph carefully:

Well, we're five minutes from the end of the game, and the score is Scotland 2, England 2. And Stevens, the English midfield player, has got the ball...he's running forward. Barnes is in the middle and he wants the ball... **Can Steven's see him?** Yes, he can. It's Stevens to Barnes...Barnes is going round Macintosh...he's going round McDonald... Yes! And it's a goal! In the 87th minute! And it's Scotland 2 and England 3.

Look at the highlighted sentence and complete the following sentence:

The commentator _____.

- A. knows that Stevens is able to see Barnes.
- B. thinks that Stevens is able to see Barnes.
- C. isn't sure that Stevens is able to see Barnes.
- D. is afraid that Stevens is able to see Barnes.

45. Read the following paragraph:

Ginger's pocket money is steady. However, she has a multiple source pocket money. Her father always gives her 23€ on the first of the month. Her mother, who also works, but doesn't live with her and her father, sends her a cheque to 56€ In addition, her grandmother regularly deposits 33€ on Ginger's bank account. Therefore, the amount of her monthly pocket money is _____.


- A. hundred and two Euros
- B. hundred and twelve Euros
- C. hundred and twenty-two Euros
- D. hundred and thirty-two Euros

MATEMATIKË

46. Është dhënë figura


Cila nga shprehjet vijuese paraqet syprinën e figurës?

- A. $ab + de$
- B. $af + bc$
- C. $ab - ed$
- D. $bc - fe$



47. Sipas grafikut të funksionit të dhënë në figurë, sa është $f(-1) + f(0)$?

- A. 0
- B. 1
- C. 2
- D. 3



48. Laura në ditën e parë të muajit mars shpenzoi 1€ ditën e dytën shpenzoi 2€ në ditën e tretë 3€ e kështu me radhë. Cili pohim është i saktë për shumën e parave që shpenzoi Laura nga dita e parë e marsit deri më 16 mars?

- A. më pak se 120€
- B. ndërmjet 120 € dhe 130€
- C. ndërmjet 130 € dhe 140€
- D. më shumë se 140€

49. Në qoftë se vlen $x^3 - y^3 = 28$ dhe $x - y = 4$, atëherë sa është vlera e $x^2 + xy + y^2$?


- A. 8
- B. 7
- C. 6
- D. 5

50. Sa është vlera e shprehjes numerike komplekse: $A = (\sqrt{1+i} - \sqrt{1-i})^2$, ku $i^2 = -1$?

- A. $A = 0$
- B. $A = 1$
- C. $A = 2 + 2\sqrt{2}$
- D. $A = 2 - 2\sqrt{2}$

51. Cili ekuacion kuadratik i përgjigjet gjetjes së x sipas të dhënave në figurë?

- A. $x^2 + 10x - 39 = 0$
- B. $x^2 + 10x + 39 = 0$
- C. $x^2 - 10x - 39 = 0$
- D. $x^2 - 10x + 39 = 0$



52. Pagesat e punonjësve në një kompani jepen në tabelën e mëposhtme.


Sa është paga mesatare në kompani?

- A. 315 €
- B. 335 €
- C. 350 €
- D. 375 €

| Pagesa | Merret prej |
|--------|--------------|
| 320€ | 2 teknikësh |
| 400 € | 1 inxhinieri |
| 280€ | 6 punëtorësh |
| 430€ | 1 menaxheri |

53. Janë dhënë figurat.

Cila formulë i përgjigjet numrit të të gjithë rrathëve të figurës së n -së, nëse kështu vazhdohet ndërtimi i tyre?



- A. 2^n
- B. $2n$
- C. $2n - 1$
- D. $2^n - 1$

54. Në një shportë ka më pak se 100 mollë. Mollët mund të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet 2, 3 ose 5 fëmijësh, por jo ndërmjet 4 fëmijësh. Sa mollë ka në shportë?

- A. 60
- B. 30
- C. 15
- D. 6

55. Me cilën shprehje është ekuivalente shprehja $(2^{-1} \cdot \sqrt[3]{2})^{-3}$?

- A. $\frac{1}{2}$
- B. $\frac{1}{4}$
- C. 2
- D. 4


56. Në qoftë se $\log_a 16 = 4$, atëherë sa është vlera e $a - 2$?

- A. 0
- B. 2
- C. 4
- D. 16

57. Është dhënë figura.

Sa është lartësia e shtyllës sipas të dhënave në figurë ?

- A. 1 m
- B. 1.5 m
- C. 2 m
- D. 2.5 m



58. Dy zare (kube për lojë) në faqet e të cilave janë shënuar numrat prej 1 deri 6 hidhen njëkohësisht. Sa është gjasa që të fitohet shuma 9 ?

- A. $\frac{1}{18}$
- B. $\frac{1}{9}$
- C. $\frac{1}{36}$
- D. $\frac{7}{36}$

59. Sa është vlera e $\frac{\sin \pi + \log_{10} 100 + 3^0}{5^{-1}}$?

- A. 5
- B. 15
- C. $\frac{1}{5}$
- D. $\frac{1}{15}$

60. Sa është vlera e shprehjes: $\frac{V_n^2 \cdot P(6)}{4!}$?

- A. $30(n-1)$
- B. $30n(n-1)$
- C. 30
- D. $30n$

HISTORI

- 61.** Cila nga shtresat shoqërore në Spartën e lashtë përfaqësonte shtresën e mesme ?
- A. Spartanët
 - B. Helotët
 - C. Periekët
 - D. Geruzia
- 62.** Cilat shtete themeluan Aleancën Trepalëshe në gjysmën e dytë të shekullit XIX?
- A. Gjermania, Austro-Hungaria, Italia
 - B. Turqia, Greqia, Polonia
 - C. Rusia, Ukraina, Bjellorusia
 - D. Anglia, Irlanda, Austro-Hungaria
- 63.** Cili ishte shteti i parë mesjetar që filloi me dërgimin e përfaqësuesve të përhershëm diplomatik në mbretëritë evropiane?
- A. Mbretëria Osmane
 - B. Republika e Gjenovës
 - C. Perandoria Bizantine
 - D. Republika e Venedikut
- 64.** Cili ishte dokumenti i parë i shkrimit shqip ?
- A. Kronika e Janinës
 - B. Formula e pagëzimit
 - C. Historia e familjes Muzaka
 - D. Historia e Skënderbeut
- 65.** Cilat ngjarje gjatë shekullit XVI sollën ndryshime në jetën politike dhe fetare në Evropën Perëndimore?
- A. Fillimi i reformacionit, i cili dënonte keqpërdorimet e Kishës Katolike dhe kërkonte që Bibla të ishte bazë e besimit
 - B. Fillimi i reformacionit, i cili dënonte keqpërdorimet e Kishës Ortodokse dhe kërkonte që Bibla të ishte bazë e besimit
 - C. Fillimi i reformacionit, i cili dënonte keqpërdorimet e Kishës Katolike dhe të Kishës Ortodokse
 - D. Fillimi i reformacionit, i cili dënonte keqpërdorimet e Kishës Ortodokse dhe kërkonte që Papati të ishte bazë e besimit
- 66.** Cilat ishin elementet e përbashkëta të politikës ekonomike të Teodor Ruzveltit dhe të Adolf Hitlerit ?
- A. Që të dy zbatuan parimin e mosndërrhyrjes së shtetit në jetën ekonomike, investuan në punët publike duke zvogëluar papunësinë
 - B. Që të dy zbatuan parimin e ndërhyrjes së shtetit në jetën ekonomike, investuan në punët publike duke zvogëluar papunësinë
 - C. Që të dy zbatuan parimin e politikës së armatosjes që rriti papunësinë
 - D. Që të dy zbatuan politikën agresive ndaj fqinjëve

67. Cili ishte qëllimi i “Ligjeve Drakonike” ?
- A. Kufizimi i pronës private dhe mbrojtja e aristokracisë
 - B. Mbrojtja e pronës private dhe dënime të lehta për shkelësit e ligjit
 - C. Dënime me largim nga pjesëmarrja në jetën publike
 - D. Mbrojtja e pronës private dhe dënime të ashpra për shkelësit e ligjit

68. Cili ishte qëllimi i mbajtjes së Kongresit të Elbasanit të vitit 1908 ?
- A. Avancimi i arsimit në gjuhën shqipe dhe hapja e shkollave të reja
 - B. Organizimi i luftës së armatosur kundër Perandorisë Osmane
 - C. Shqyrtimi i problemit të alfabetit të gjuhës shqipe
 - D. Organizimi i luftës së armatosur kundër xhonturqve

69. Çka u vendos në Konferencën e Bujanit 1943-1944 ?
- A. Kosova të shpallej Republikë
 - B. Të formohet Federata e shteteve Ballkanike
 - C. Kosova me viset e tjera shqiptare t’i bashkohet shtetit amë
 - D. Të formohet Federata Kosovë-Shqipëri

70. Në hartën e dhënë në pjesën e vijëzuar është paraqitur zona okupuese e Shqipërisë gjatë Luftës së Parë Botërore nga:
- A. Austro-hungarezët
 - B. Francezët
 - C. Italianët
 - D. Ruso-Turkët



71. Në bazë të Traktatit të fshehtë të Londrës (1915), Italia inkuadrohet në luftë në anën e Antantës. Çfarë solli inkuadrimi i Italisë në këtë aleancë?
- A. Dobi të vogël për fuqitë e Antantës
 - B. Dobi të madhe për fuqitë e Antantës
 - C. Solli dobi, por vetëm në Frontin Lindor
 - D. Solli dobi, por vetëm në Frontin Jugor

72. Në cilin parim mbështeteshin vendimet e Kongresit të Vjenës të vitit 1815 ?
- A. Mbështeteshin në parimin e barazisë dhe të drejtave të njeriut
 - B. Mbështeteshin në parimin e së drejtës së popujve për vetëvendosje
 - C. Mbështeteshin në parimin e ndalimit të rikthimit në fron të familjeve të vjetra mbretërore të pararevolucionit
 - D. Mbështeteshin në parimin e “Legjitimitetit” apo rikthimit në fron të familjeve të vjetra mbretërore të pararevolucionit.

73. Çfarë përmbante Deklarata e Pavarësisë së SHBA-së në lidhje me të drejtat e njeriut?
- A. Të gjithë njerëzit janë të barabartë nëse i takojnë shoqërisë amerikane
 - B. Të gjithë njerëzit janë të barabartë nëse i takojnë besimit katolik
 - C. Të gjithë njerëzit lindin të barabartë dhe kanë të drejta të patjetërsueshme
 - D. Të gjithë njerëzit janë të barabartë nëse i takojnë besimit protestant

GJEOGRAFI

74. Cili është liqeni natyral me lartësi më të madhe mbidetare në trojet etnike?
A. Liqeni i Shkodrës
B. Liqeni i Ohrit
C. Liqeni i Prespës
D. Liqeni i Butrintit


75. Cili shtet ka sipërfaqe më të madhe sesa Kosova :
A. Luksemburgu
B. Sllovenia
C. Andora
D. Monako

76. Stalaktitet janë:
A. forma akumulative krasike
B. forma akumulative eolike
C. forma erozive eolike
D. forma erozive fluviale

77. Shkretëtira e Patagonisë gjendet në:
A. Azi
B. Afrikë
C. Amerikën Veriore
D. Amerikën Jugore

78. Cila nga format e krijuara me shkarje (lëvizje tektonike) është paraqitur në figurë?

- A. Shkallëzimi tektonik
- B. Grabeni
- C. Horsti
- D. Fleksura



79. Sipas llojit të produkteve ose shërbimeve, veprimtaritë ekonomike ndahen në tre sektorë (primarë, sekondarë dhe terciarë).

Cila nga veprimtaritë hyn në sektorin dytësor (sekondar)?

- A. Xehetaria, industria, ndërtimtaria, zëjtaria prodhuese
- B. Zëjtaria prodhuese, industria, arsimi, shëndetësia
- C. Ndërtimtaria, administrata, industria, kultura
- D. Industria, sigurimi, xehetaria, tregtia


80. Në morfologjinë e relievit, malet janë element kryesor gjeografik i natyrës së trojeve shqiptare.

Cili nga pohimet është i saktë për malet Rodope, si pjesë e kësaj morfologjie?

- A. Rodopet janë male të reja, me lartësi mesatare mbidetare dhe shkëmbinj sedimentarë
- B. Rodopet janë male të vjetra, me lartësi të vogël mbidetare dhe shkëmbinj kristalor
- C. Rodopet janë male të reja, me lartësi të madhe mbidetare dhe shkëmbinj kristalor
- D. Rodopet janë male të vjetra, me lartësi mesatare mbidetare dhe shkëmbinj sedimentarë

81. Cili është kryeqyteti i shtetit të hijezuar në hartë ?

- A. Pekini
- B. Tokio
- C. Nju Delhi
- D. Bangkoku



82. Tregues të strukturës së popullsisë sipas gjinisë janë koeficienti i maskulinitetit dhe koeficienti i feminitetit. Si llogaritet koeficienti i maskulinitetit? (Km-kof. maskulinitetit, Pf-pop femërore, Pm- pop. mashkullore) ?

- A. $Km = \frac{Pm}{Pf} \cdot 1000$
- B. $Km = \frac{Pf}{Pm} \cdot 1000$
- C. $Km = \frac{1000}{Pm} \cdot Pf$
- D. $Km = \frac{1000}{Pf} \cdot Pm$

83. Pse rrethi tropik është më i gjatë sesa rrethi polar?

- A. Sepse është më afër pikës polare
- B. Sepse është më afër ekuatorit
- C. Sepse është meridian fillestar
- D. Sepse është meridian ndihmës

84. Nëse ndodhemi në qytetin e Mitrovicës, në cilën anë të horizontit gjendet qyteti i Gjakovës?

- A. Verilindje
- B. Veriperëndim
- C. Juglindje
- D. Jugperëndim

85. Për çfarë arsye erërat monsunë verore në Azinë Jugore gjatë verës fryjnë prej oqeanit në drejtim të tokës (kontinentit)?

- A. Verës ajri është më i ftohtë dhe shtypja më e ulët në det sesa në tokë
- B. Verës ajri është më i nxehtë dhe shtypja më e lartë në det sesa në tokë
- C. Verës ajri është më i ftohtë dhe shtypja më e lartë në det sesa në tokë
- D. Verës ajri është më i nxehtë dhe shtypja më e ulët në det sesa në tokë

- 86.** Si procedon metoda deduktive?
- A. Nga e përgjithshmja në të veçantën
 - B. Nga e përveçmja në të përgjithshmen
 - C. Nga e veçanta në të veçantën
 - D. Nga përvoja në arsye
- 87.** Çfarë do të thotë teza themelore e ekzistencializmit: “Ekzistenca i paraprin esencës”?
- A. Njeriu në fillim është një esencë e gatshme, dhe pastaj fillon të ekzistojë
 - B. Njeriu së pari fillon të qeniesojë, dhe pastaj të ekzistojë
 - C. Njeriu fillon së pari të ekzistojë, të hasë vetveten në botë dhe pastaj ta përkufizojë vetveten si njeri
 - D. Njeriu fillon së pari të ekzistojë e pastaj të veprojë
- 88.** Nëse personi A është duke e ndjekur personin B për t’u fjalosur me të, dhe personi B fshihet te personi C (në oborrin e tij), kurse personi A e pyet personin C se ku gjendet personi B dhe personi A i tregon personit C se ka për qëllim të fjaloset me personin B, atëherë si duhet të veprojë personi C sipas etikës kantiane (të Kantit)?
- A. Personi C duhet ta fshehë personin B nga personi A dhe s’duhet t’i tregojë personit A se ku gjendet personi B, d.m.th. duhet të gënjejë
 - B. Personi C duhet ta tregojë të vërtetën se ku gjendet personi B, pra ai nuk duhet ta gënjejë personin A
 - C. Personi C duhet ta dëbojë personin A, sepse personi B gjendet në pronën (oborrin) e tij
 - D. Personi C duhet ta thërrasë policinë për ta shpëtuar personin B dhe për ta prangosur personin A që është në tentim fyerjeje dhe duhet ta fshehë personin B
- 89.** Në konkludimin ose argumentin e dhënë si më poshtë:
- I. Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm**
 - II. Sokrati është njeri**
 - III. Pra, Sokrati është i vdekshëm**
- ku gjenden saktësisht premisat?
- A. Në gjykimet I dhe II
 - B. Në gjykimet II dhe III
 - C. Vetëm në gjykimin I
 - D. Vetëm në gjykimin III
- 90.** Cili nga gjykimet e mëposhtme paraqet pikëpamjen estetike objektivistë?
- A. Objektet nuk varen nga subjekti, kurse ai i shikon ato vetëm subjektivisht
 - B. Subjekti e përcakton të bukurën, e ajo nuk gjendet në objekte
 - C. E bukura ekziston jashtë subjektit si diçka objektive
 - D. E bukura nuk ekziston jashtë subjektit, por as në objekte

PSIKOLOGJI

91. Ndikimin e faktorëve shoqëror në sjelljet, besimet dhe qëndrimet e individit i studion:

- A. Psikologjia sociale
- B. Psikologjia zhvillimore
- C. Psikologjia eksperimentale
- D. Psikologjia fiziologjike

92. Çka paraqet Inkibicioni Retroaktiv ose frenimi prapavajtës si një prej shkaqeve të harresës ?

- A. Pengesën apo harresën që mësimi i tashëm i shkakton të vjetrit
- B. Pengesën apo harresën që mësimi i vjetër i shkakton të tashmit
- C. Pengesën apo harresën që ndodh për shkak të mospërdorimit
- D. Pengesën apo harresën që ndodh në mënyre spontane

93. Çka janë paragjykimet?

- A. Sjellje negative ndaj një grupi dhe anëtarëve të tij
- B. Besime të gabuara përgjithësuere ndaj një grupi dhe anëtarëve e tij
- C. Qëndrime negative të pajustificueshme ndaj një grupi dhe anëtarëve të tij
- D. Qëndrime të gabuara të justifikueshme ndaj një grupi dhe anëtarëve të tij

94. Koeficienti intelektual është raporti në mes moshës mendore të një personi me moshën


e tij kronologjike; $KI = (MM/MK) \times 100$. Nëse moshja mendore e një fëmije është 3 vjeç dhe moshja e tij kronologjike është 5 vjeç atëherë KI është;

- A. 50
- B. 60
- C. 70
- D. 80

95. Psikologët e shkollës geshtaltiste përcaktuan parimet, të cilat i quajtën ligje në bazë të të cilave formohet tërësia perceptivë.

Cili parim është paraqitur në figurë?

- A. Parimi i afërsisë
- B. Parimi i simetrisë
- C. Parimi i ngjashmërisë
- D. Parimi i mbylljes



SOCIOLOGJI

- 96.** Familja në të cilën vendimet kryesore i merr femra quhet:
- A. Patriarkat
 - B. Poligami
 - C. Matriarkat
 - D. Monogami
- 97.** Ogyst Konti në teorinë e tij, konsideronte se bota gjatë historisë së saj ka kaluar nëpër tri faza të zhvillimit intelektual; faza teologjike, faza metafizike, faza pozitiviste. Çka e karakterizon fazën pozitiviste?
- A. Besimi në shkencë
 - B. Besimi në forcat e ndryshme abstrakte
 - C. Besimi në fuqitë mbinatyrore hyjnore
 - D. Besimi në individin
- 98.** Eklesitë janë:
- A. Organizata fetare që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me shtetin
 - B. Organizata fetare jozyrtare dhe jo të integruara mirë në shoqëri
 - C. Organizata fetare jozyrtare me qëndrim konformist ndaj sistemit shoqëror
 - D. Organizata fetare zyrtare me qëndrim konformist ndaj sistemit shoqëror
- 99.** Tre tipa të pastër të pushtetit legjitim sipas Weberit janë:
- A. Tradicional, Demografik, Politik
 - B. Tradicional, Legal-Racional, Karizmatik
 - C. Legal-Racional, Entografik, Ideologjik
 - D. Legal-Racional, Ideologjik, Ekonomik
- 100.** Çfarë kanë të përbashkët klasat dhe rendet:
- A. Janë forma të pabarazisë shoqërore
 - B. Janë forma të asimilimit të popullatës
 - C. Janë të rregulluara me ligj
 - D. Janë të rregulluara me religjion